REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KESHILLI BASHKIAK

Nr 2053/2 **Prot.** **Laç më** 24.04.**2023**

VENDIM

Nr 28 **. Datë** 24.04 **.2023**

"PËR MBËSHTETJE FINANCIARE NGA FONDI REZERVË"

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, " Për Vetëqeverisjen Vendore", në Ligjin Nr. 67, Datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin Nr.22, datë 03.05.2018 "Për Strehimin Social" dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 106, date 21.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023, pas propozimit nga Kryetarja e Bashkisë,Këshilli Bashkiak:

VENDOSI;

1. Të miratohet ndihma financiare për akomodimin e familjeve për periudhen **1- vjeçare** të ambjenteve të marra me qera për familjet:

[redacted]

2. Të miratojë efektin financiar sipas tregut për banesat, në qytetin e Laçit :

- **Për banesa 1+1 : 12.400 x 15% (tatim burimi) = 14.260 lek në muaj.** *(171.120 lek në vit)*
- **Për banesa 2+1 : 15.600 x 15% (tatim burimi) = 17.940 lek në muaj.** *(215.280 lek në vit)*

3. Miratimin e kryerjes së shpenzimeve noteriale të mbulohen nga Bashkia Kurbin.

4. Afati i lëvrimit të mjeteve financiare fillon në momentin hyrjes në fuqi të vlefshmërisë së kontratës të noterizuar pranë Noterit nëpërmjet tri palëve (Qeradhënësi, Qeramarrësi dhe Bashkia Kurbin).

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes .

Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetaria e Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë

>Drejtoria e Financave

>Drejtoria e sherbimeve publike

SEKRETARI I KESHILLIT

Arber LEKA

KRYETARE E KESHILLIT

Edlira LLESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KURBIN